

VENDIM
Nr. 606, datë 17.9.2014
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 903, DATË 26.8.2009, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË KËRKIMIT,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT (AKTI)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 903, datë 26.8.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 7, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në fund të paragrafit shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Ministri përgjegjës për inovacionin është nënkryetar i bordit drejtues të AKTI-t.”.
 - b) Në pikën 7.1, fjalët: “Zëvendësministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit”, shfuqizohen.
 - c) Në pikën 7.4, pas “Kryetari”, shtohet “nënkryetari”.
2. Në pikën 8.1 fjalët “... të ketë gradën shkencore doktor...”, shfuqizohen.
3. Pikat 8.2 dhe 8.3, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama